



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Nr. Prot. Org. / Prot. No.:	02
Nr. Prot. / Prot. No.:	05-179
Nr. faqeve / Stranice:	-5-
Data / Datum:	13.01.2023
Prishtinë / a	

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Prot. Org. / Prot. No.:	02/481
Nr. Prot. / Prot. No.:	67/2023
Nr. faqeve / Stranice:	2.1
Data / Datum:	13.01.23
PRISHTINË/A	

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFERIT

DHE

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Marrë parasysh ndryshimet e sjella nëpërmjet Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, lidhur me barten e Institutit Special të Shtimes dhe Shtëpisë së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar (tash e tutje: institucionet e kujdesit rezidencial) nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për në Ministrinë e Shëndetësisë, palët lidhin këtë marrëveshje të bashkëpunimit, me qëllim të rregullimit të procedurave të bartjes, në mbështetje të nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Palët e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi janë:

Ministria e Shëndetësisë (tash e tutje MSh), e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministri i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiq;

dhe

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tash e tutje MFPT), e përfaqësuar nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm z. Enis Spahiu

Palët u morën vesh si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është bartja/kalimi i përgjegjësive të menaxhimit të institucioneve të kujdesit rezidencial nga MFPT në kuadër të MSh-së, si dhe rregullimi i ndërveprimit të dy ministrive deri në bartjen e plotë të përgjegjësive.

Neni 2 Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit janë institucionet e kujdesit rezidencial që ofrojnë shërbime dhe strehim për personat me aftësi të kufizuar të rritur dhe fëmijë.

Neni 3 Obligimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

1. MFPT ia siguron MSh-së listën e pagave të zyrtarëve të institucioneve të kujdesit rezidencial brenda (5) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
2. MFPT ofron dhe transferon MSh-së dokumentacionin dhe dosjet në formë fizike dhe elektronike, për stafin e institucioneve të kujdesit rezidencial, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

3. MFPT përgatit një raport për gjendjen e pasurisë së institucioneve të kujdesit rezidencial dhe nxjerr raportet e pasurisë për secilin zyrtar, dhe në bashkëpunim me MSh-në bën transferin e këtyre pasurive nga MFPT në MSh, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

4. MFPT ofron një listë të kontratave të prokurimit të nënshkruar për nevojat të institucioneve të kujdesit rezidencial, dhe i mundëson MSh-së që nga kontratat e nënshkruara të vazhdohet me realizimin e kërkesave dhe furnizimeve për nevoja të këtyre dy institucioneve, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

5. MFPT ofron dhe dorëzon MSh-së një listë të obligimeve dhe faturave të cilat nuk kanë arritur të ekzekutohet nga buxheti i vitit 2022, për shkak të mbylljes së afateve të pagesave dhe për shkak se pranimi i disa furnizimeve apo blerjeve është realizuar gjatë muajit dhjetor/2022, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

6. MFPT ofron MSh-së kornizën e akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave duhet të vazhdojnë punën dhe ofrimin e shërbimeve këto institucione të kujdesit rezidencial, si dhe të gjitha draftet e punës që akteve ligjore dhe nënligjore të cilat kanë qenë në proces të plotësimit/ndryshimit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

7. MFPT do të asistojë kurdo që paraqitet ndonjë kërkesë nga MSh, lidhur me procesin e bartjes dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

Neni 4

Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. MSh siguron që lista e pagave e pranuar sipas pikës 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje të vendoset në sistemin e pagave për pagat e muajit Janar 2023, më së largu deri në fund të muajit Janar të vitit 2023.

2. MSh në kuadër të strukturës së saj organizative dhe rregullore të brendshme të organizimit përfshin këto dy institucione në nivel departamenti (Instituti Special në Shtet) dhe në nivel divizioni (Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar), nëse analizat e MSh-së nuk rekomandojnë ndonjë opsion tjetër për këto struktura.

3. MSh kujdeset që stafi i këtyre dy institucioneve të kujdesit rezidencial në procesin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës të trajtohet si staf shëndetësorë (përgjashtimit shërbyesit civil dhe të angazhuarit me legjislacionin e punës) dhe të vazhdohet me realizimin e kompensimeve në kujdestari dhe shtesa ashtu siç është aplikuar deri tani.

4. MSh shfrytëzon të gjitha kontratat aktuale në fuqi për realizimin e kërkesave, furnizimeve apo blerjeve për nevoja të këtyre institucioneve dhe se të gjitha obligimet të dala nga realizimi i këtyre kërkesave ekzekutohet nga buxheti i aprovuar dhe kodet e nën programeve të këtyre institucioneve të kujdesit rezidencial.

5. MSh në bashkëpunim me këto institucioneve të kujdesit rezidencial identifikon dhe angazhohet në iniciimin e procedurave të reja të prokurimit për shërbime, furnizim apo blerje të reja si dhe bëje përgatitjet për iniciimin e procedurave për kontratat që do të skadojnë nga janari/2023, duke vendosur këto në Planin e Prokurimit të MSh-së.

6. MSh merr përsipër të gjitha obligimet ligjore dhe procedurale të incuara apo të dakorduara nga MFPT para datës 01.01.2023 (procedura lidhur me marrëdhënien e punës, procedura lidhur me çështjet disiplinore, obligimet nga planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Avokati i Popullit si dhe obligime të ngjashme).

7. MSh obligohet të zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe vendimet e institucioneve të niveli lokal apo qendror, për vlerësimin profesional dhe vendosjen e tyre në këto institucione të kujdesit rezidencial, deri në ndryshimet ligjore që mund të përcaktojnë ndryshe mënyrën e vlerësimit dhe vendosjes së rezidentëve në këto institucione.

8. MSh do të bashkëpunojë me institucionet tjera përgjegjëse të nivelit qendror sa i përket zhvillimit të politikave, standardeve dhe strategjisë për shërbimet që do të ofrohen nga këto dy institucionet të kujdesit rezidencial.

9. MSh do të bashkëpunojë me institucionet e nivelit komunal dhe qendror për mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimit të ofrimit të shërbimeve nga këtyre dy institucione rezidenciale.

Neni 5

Periudha transitore

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje pajtohen që periudha transitore për bartjen e tërësishme të menaxhimit të këtyre dy institucioneve është data 30.06.2023.

2. Përgjatë kësaj periudhe transitore, MSh mund të kërkojë nga MFPT realizimin e pagesave të caktuara, të cilat për shkaqe të planifikimit buxhetore nuk mund të realizohen nga MSh. Kërkesat e tilla duhet të jenë të arsyetuara.

Neni 6
Mosmarrëveshjet

1. Çdo kontest apo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje, do të zgjidhet në frymë bashkëpunimi dhe me qëllimin e përbashkët të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës.
2. Në rast të krijimit të rrethanave të reja, palët me dakordim të dyanshëm mund të lidhin aneks-marrëveshje për adresimin e rrethanave të reja.

Neni 7
Personat përgjegjës për zbatim të marrëveshjes

2. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, pajtohen që të caktojnë personat përgjegjës të autorizuar për komunikim ndërmjet tyre lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshje, si vijon:

- 1.1 Për MSh – znj. Kadrije Berisha;
- 1.2 Për MFPT – z. Nexhat Sylja.

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri në transferimin e plotë të përgjegjësisë nga MFPT për në MSh, por jo më larg se 01.01.2024
3. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është e nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh

Në: Prishtinë
Datë: 13.01.2023

Enis Spahi
Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MFPT

